



Prishtinë, 29 dhjetor 2010

Kodi i ZRRE-së: V\_331\_2010

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Kërkesën e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH.A për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore, të datës 22 tetor 2010,

**në seancën e mbajtur me datë 29 dhjetor 2010, nxori këtë:**

**VENDIM**

- I. APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për sezonin e ngrohjes 2010/2011, të cilat do të zbatohen prej datës 01 janar 2011, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B" .

**Arsyetim**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 22 tetor 2010 nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH. A ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore.
  2. Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh:
    - Të Ardhurat e Lejuara siç janë përcaktuar në dokumentin: Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakova SH.A. – Sezoni i Ngrohjes 2010/2011; dhe
    - Llogaritjen e detajuar të tarifave siç paraqitet në dokumentin: Përcaktimi i Tarifave për NQ Gjakova SH.A. – Sezoni i Ngrohjes 2010/2011.
  3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II** Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Gjakova SH. A për sezonin e ngrohjes 2010/2011 janë si në tabelën e mëposhtme:

**TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVË SH.A.  
PËR SEZONIN E NGROHJES 2010/2011**

**Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE**

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.11 [€/m <sup>2</sup> për mua]]	0.14 [€/m <sup>2</sup> për mua]]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.79 [€/m <sup>2</sup> për mua]]	1.14 [€/m <sup>2</sup> për mua]]

**Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE**

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.	
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	1.10 [€/kW për mua]]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	53.67 [€/MWh]

- III. NQ Gjakova SH.A duhet ta publikojë këtë vendim në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë, brenda pesë (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejt, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova SH.A. për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Gjakova SH.A. në aplikacionin për tarifa.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Përparim Kabashi, Anëtar

\_\_\_\_\_  
Blerim Koci, Anëtar